



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

**RAPORT STUDIMOR I VENDIMEVE TË PROKURORISË DHE GJYKATËS SË RRETHIT
GJYQËSOR KRUIË PËR PERIUdhËN JANAR 2015 – MARS 2017**

Lidhur me hetimin dhe gjykimin e veprës penale të parashikuar nga Neni 201, i Kodit Penal, “Ndotja e ajrit”, në vijim të denoncimit të vazhdueshëm nga media investigative të ndotjes së shkaktuar në disa fshatra të Bashkisë Krujë, nga veprimtaritë e paligjshme të djegies së furrave gëlqerore

Dhjetor 2017

Kontribuan për realizimin e këtij raporti:

1. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH
2. Andi Muratej, Avokat pranë Klinikës Ligjore Falas, KShH
3. Iva Bregasi, Juriste/ Asistente Projektsh, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij raporti nuk mund të riprodhohet pa lejen e autorit.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit



Komiteti Shqiptar i Helsinki

Adresa: Rr. Brigada e 8-te, Pallati “Tekno Projekt”
Shk. 2 Ap. 10, Tiranë – Shqipëri
Kutia Postare 1752

Disclaimer: Ky raport studimor mbështetet financiarisht nga Programi i Grantëve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.



PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. Hyrje

2. Përmbledhje Ekzekutive

3.1 Konstatime të përgjithshme

3.2 Mbi gjetjet nga analiza e vendimeve të prokurorisë

3.3 Mbi gjetjet nga analiza e vendimeve të gjykatës

3. Metodologjia

4. Analizë e kallëzimeve penale dhe vendimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë

4.1 Veprimtaria e Policisë Krujë dhe bashkëpunimi me autoritetet vendore

4.2 Subjektet që kanë iniciuar procesin penal

4.3 Veprimet dhe afatet hetimore

4.4 Analiza e shkaqeve për mosfillimin e procedimit penal dhe të pushimin e çështjeve penale

4.5 Respektimi i të drejtës së ankimit për vendimet e prokurorisë

5. Analizë e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë

5.1 Subjektet që kanë iniciuar procesin

5.2 Masat shtrënguese për të pandehurit

5.3 Procedimi me gjykim të shkurtuar

5.4 Arsyetimi i vendimeve gjyqësore

5.5 Lloji dhe masa e dënimit

6. Rekomandime

1. Hyrje

Ndotja e mjedisit është një problem shqetësues, i cili vitet e fundit është sjellë në vëmendje nga media dhe organizata të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare. Sipas të dhënave të referuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), rreth 2.4 milion persona vdesin çdo vit nga shkaqe që lidhen me ndotjen e ajrit, ku 1.5 milion të vdekjeve ndodhin për shkak të ndotjes së ajrit. Ndërsa, në Europë rreth 310.000 individë vdesin çdo vit për shkak të ndotjes së ajrit¹.

Fenomeni i ndotjes së ambientit konstatohet me nota shqetësuese edhe në vendin tonë. Në Raportin mbi situatën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri për vitin 2016, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) vërejtë ndër të tjera se: *“Dëmtimi i pyjeve, si pasojë e prerjes së pemëve pa kriter, shfrytëzimi i inerteve të lumenjve, duke dëmtuar rrjedhën e tyre natyrore, hedhja e mbetjeve të ndërtimit buzë ujrave natyrore si, lumenj e liqene, lëshimi i gazrave ndotës në ajër dhe veprime të tjera abuzive, kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në mjedis. Organet përgjegjëse të pushtetit publik, në nivel qendror dhe vendor nuk kanë mundur të reagojnë mjaftueshëm për t’i parandaluar këto veprime. Gjithashtu, organet e sistemit të drejtësisë penale nuk kanë qenë efektive në drejtim të vënies para përgjegjësisë penale të autorëve të veprave penale në fushën e mjedisit.”*

Sipas Kushtetutës së RSH, një nga objektivat sociale që shteti duhet të realizojë, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon është të garantojë mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Vendi ynë ka miratuar një nga ligjet më të rëndësishme që rregullon veprimtarinë në fushën e mjedisit, përkatësisht Ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Ky ligj synon ndër të tjera, mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Personat fizikë apo juridikë që ushtrojnë veprimtari që shkaktojnë ndotje në mjedis, duhet të pajisen me lejen përkatëse të mjedisit, ku përcaktohen, me shkrim, kushtet e nevojshme për të garantuar se veprimtaria/instalimi do të përmbushë kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi. Gjithashtu, Ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, parashikon rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë, masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe masat për pakësimin e shkarkimeve në gjendje të gaztë, të lëngët e të ngurtë në ajër, ujë e tokë.

Një akt tjetër mjaft i rëndësishëm në këtë drejtim është Strategjia Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit², që vendos objektiva dhe përcakton politikën për të përmirësuar më tej cilësinë e ajrit në Shqipëri për një periudhë afatgjatë. Kjo strategji parashikon gjithashtu, hapa për bashkërendimin dhe përafrimin e kuadrit të tanishëm ligjor me legjislacionin evropian, si dhe zbatimin e tij.

¹ Referuar portalit Ikub.al: <http://www.ikub.al/Lajme/1411020030/Article-Ndotja-e-ajrit-rrezik-i-madh-per-femijet-.aspx>

² Miratuar me VKM nr. 954, dt. 10.09.2014

Prej disa vitesh, ndotja e ajrit për shkak të veprimtarisë së furrave gëlqerore, të përqendruara kryesisht në disa fshatra të Bashkisë Krujë është tepër shqetësuese. Media investigative dhe në mënyrë të veçantë emisioni investigativ “Fiks Fare”, i televizionit “Top Channel” ka dhënë në mënyrë të vazhdueshme alarmin për kërcënimin që i shkaktojnë këto furra, jetës dhe shëndetit të qindra banorëve në fshatrat përreth por gjithashtu edhe të një numri më të gjerë banorësh që janë në zonat fqinje. Këto veprimtari ushtrohen në mënyrë të paligjshme, me metoda dhe mënyra tepër të dëmshme dhe primitive për ambientin dhe shëndetin e popullatës. Ajo çka vihet re është një neglizhencë dhe mungesë koordinimi mes organeve të ngarkuara me kompetenca të natyrës administrative apo penale, për t’i dhënë fund veprimtarisë së këtyre furrave. Çështja e ushtrimit të kësaj veprimtarie të paligjshme dihet nga të gjithë, përfshi organet kompetente, por për shkaqe të dyshimta është toleruar. Përgjegjësi për këtë ka edhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Edhe në ato raste kur janë ndërmarrë masa administrative apo penale, ato kanë qenë jo efektive pasi nuk kanë mundur të godasin përfundimisht këto veprimtari të paligjshme. Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve (ISHMP) ndërmori në muajin Mars të vitit 2017, një operacion për mbylljen e 21 furrave funksionale të gëlqeres në zonën e Fushë-Krujës. Për herë të parë mbyllja e furrave të gëlqeres nga ISHMP u realizua në vitin 2013, kur u identifikuan 220 furra funksionale gëlqereje në këtë zonë. Sipas të dhënave të pasqyruara në median online, si pasojë e ndërmarrjes së aksioneve të ndryshme, në vitin 2015 numri i tyre u ul në 110 furra gëlqerore dhe aktualisht pretendohet të jenë më pak.³ Megjithatë, vlerësohet se operacionet e ndërmarra nga strukturat shtetërore janë të fragmentarizuara, mungon koordinimi mes organeve në nivel qendror dhe vendor që kanë përgjegjësi të ndryshme për këtë çështje si dhe mungon konsistenca në drejtim të kontrollit dhe mbikqyrjes shtetërore të vazhdueshme dhe nga afër të situatës. Veprimtaria parandaluese pothuajse mungon.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) ka pranuar se, ndotja mjedisore është bërë një çështje e shqetësimit publik në dekadat e fundit, çka ka reflektuar në rritjen e jurisprudencës së kësaj gjykate për këto çështje. Në vendimet e saj, GjEDNj-ja është shprehur se megjithëse nuk ka një të drejtë të shprehur në Konventë për një mjedis të pastër, kur një individ preket në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe serioze nga zhurmat apo ndonjë formë tjetër e ndotjes, kjo mund të çojë në cenimin e nenit 8 të Konventës, “e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”. Në çështjen *Dubetska dhe të tjerë kundër Ukrainës*, GjEDNj u shpreh se mund të shkelet neni 8, i Konventës në rast se, një ndotje mjedisore është e një niveli të tillë rrezikshmërie që rezulton në dëmtime të konsiderueshme të aftësisë së ankuesit që të gëzojë shtëpinë, jetën e tij/saj private apo familjare.

Nisur nga problematika dhe dëmtimi i rëndë mjedisor i shkaktuar nga veprimtaria e paligjshme e furrave gëlqerore, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ndërmori këtë Studim, ndërkohë që paralelisht e ka ndjekur çështjen duke monitoruar në vend situatën, duke reaguar në mënyrë të vazhdueshme me deklaratat për shtyp, duke i rekomanduar institucioneve përgjegjëse ndërmarrjen e veprimeve administrative si dhe duke përfaqësuar banorët në rrugë gjyqësore për kërkimin dhe rivendosjen e të drejtave të tyre të shkelura. Procesi gjyqësor për këtë çështje është në vazhdim. Në reagimet publike të KShH-së është vënë theksi se ndotja mjedisore në Burizanë dhe Kadius të Bashkisë Krujë prek në mënyrë direkte dhe serioze shëndetin dhe jetën private të qetë, të çdo banori të kësaj

³ Revista Mjedisi Sot: <https://www.mjedisitot.info/index.php/natyre/2769-ishmp-operacion-blic-ne-fushe-kruje-per-mbylljen-e-21-furrave-gelqere>

zone, në kundërshtim me sa garantohet nga parashikimet kushtetuese dhe konventore, të detyrueshme për zbatim nga organet shtetërore.

Në këtë Studim analizohet veprimtaria hetimore dhe gjyqësore e Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, sa i takon veprës penale veprës penale “Ndotja e ajrit”, parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal. Analiza e veprimtarisë hetimore dhe gjyqësore bën të mundur vlerësimin në mënyrë të tërthortë të organeve të tjera të ngarkuara me përgjegjësi penale dhe administrative për mbrojtjen dhe kontrollin e mjedisit si Policia, Inspektoratet e Kontrollit dhe Bashkia Krujë. Studimi vë theksin në mënyrë të veçantë tek pandëshkueshmëria e krimit mjedisor në rastin e furrave gëlqerore por edhe në ato raste kur është ndëshkuar, nuk ka bërë të mundur parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të veprës penale.

Shpresojmë që ky raport studimor të rrisë efikasitetin jo vetëm të organeve të ndjekjes penale por gjithashtu edhe të organeve publike në nivel qendror dhe vendor, të ngarkuara me përgjegjësi për mbrojtjen e mjedisit dhe marrjen e masave administrative deri në kallëzim penal për çdo person fizik dhe juridik që nuk respekton rregullat dhe kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për ushtrimin e veprimtarive me natyrë fitimprurëse.

Gjejmë rastin të falenderojmë Gjykatën dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë si dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës për bashkëpunimin e tyre në realizimin e qëllimit të kësaj nisme, si dhe për gatishmërinë e tyre në dhënien e informacionit të kërkuar.

2. Përmbledhje Ekzekutive

2.1 Konstatime të përgjithshme

Në periudhën që është në fokus të këtij raporti studimor vërehet se ka patur një numër të konsiderueshëm kallëzimesh penale, të lidhura me ndotjen e ambientit për shkak të veprimtarisë së furrave gëlqerore në fshatrat e Bashkisë Krujë. Të bën përshtypje fakti që banorët e zonave të prekura nga ndotja e mjedisit nuk kanë qenë të ndërgjegjësuar mjaftueshëm për të drejtat e tyre dhe nuk i kanë kallëzuar penalisht këto veprimtari.

Ajo çka është vërejtur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit për këtë çështje është se, me përjashtim të rasteve të referuara nga policia dhe të proceduara penalisht nga prokuroria, nga banorët ka munguar gjithashtu inisiativa për kërkimin gjyqësor në rrugë civile/administrative të të drejtave të tyre të shkelura, për dëmet e mundshme që ata mund të kenë pësuar në shëndetin e tyre si pasojë e kësaj ndotje. E para çështje që është iniciuar gjyqësisht, daton në Dhjetor të 2017-ës, ku disa banorë që preken nga aktiviteti i furrave gëlqerore i janë drejtuar Gjykatës Administrative me ndihmën e avokatëve të Klinikës Ligjore Falas të KShH.

Gjithashtu, është tepër shqetësues fakti se, organet publike në nivel qendror dhe vendor të ngarkuara me përgjegjësi të natyrës administrative, inspektuese dhe verifikuese në terren kanë qenë pothuajse pasive në drejtim të ndërmarrjes së inisiativës për të kallëzuar penalisht veprimtarinë e paligjshme të furrave gëlqerore. Në asnjë prej vendimeve të prokurorisë apo të gjykatës që i janë vënë në dispozicion KShH-së nuk rezulton që Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Durrës (Inspektorati) apo Bashkia e Krujës të kenë denoncuar ndërhyrjet negative të kryera nga shtetasit apo subjektet e ndryshme të cilat kanë dëmtuar mjedisin. Kjo evidenton, së pari, mosrespektimin e detyrimit ligjor që ka çdo nëpunës publik për të bërë kallëzim penal nëse gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tij/saj, merr dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht. Së dyti, kjo e dhënë ngre dyshime të forta për një përfshirje të mundshme të këtyre nëpunësve në këtë veprimtari, duke shpërdoruar pozitat zyrtare apo duke u bërë pre e një skeme të mundshme korruptive, çka ka bërë të mos ndëshkohet efektivisht ky aktivitet i paligjshëm dhe tepër i dëmshëm për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve (referuar edhe pamjeve të publikuara në emisionin investigativ “Fiks Fare”).

Analiza e vendimeve të prokurorisë dhe të gjykatës evidenton se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë është vënë në lëvizje për ndotjen e shkaktuar nga furrat gëlqerore, më së shumti nga Komisariati i Policisë Krujë me kallëzim penal/ referim, përkatësisht në 14 raste. Megjithatë vihet re një mospërputhje e statistikave dhe e të dhënave të vëna në dispozicion nga Policia me ato të vendimeve të studiuara, lidhur me mënyrën e vënies në lëvizje të prokurorisë. Kjo pasi, sipas të dhënave të Policisë për periudhën Janar 2015 – Mars 2017, janë konstatuar 28 raste të kryerjes së kësaj vepre penale dhe në çdo rast është bërë referimi i materialeve përkatëse në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë. Ndërkohë që në vendimet e prokurorisë dhe në vendimet gjyqësore të studiuara, 25 në total, rezulton se në 9 raste, prokuroria është vënë në lëvizje me inisiativën e saj.

Pavarësisht nga statistikave të kallëzimeve, numrit të hetimeve apo gjykimeve penale për këto veprimtari, në tërësi vihet re se pothuajse në gjysmën e çështjeve, nga Prokuroria e Rrethit

Gjyqësor Krujë është vendosur pushim i çështjes penale apo mosfillim i procedimit penal. Mungesa e një hetimi të shpejtë, efektiv, të plotë dhe të gjithëanshëm vlerësojmë se ka ndikuar në këtë drejtim.

Kur çështjet janë dërguar nga prokuroria në gjykatë, kjo e fundit ka disponuar pothuajse në të gjitha rastet me vendim fajësie ndaj të pandehurve. Është tepër shqetësues argumentimi i gjykatës në vendimet e studiuara se, **teknologjia primitive e prodhimit të gëlqeres në furra nuk mundëson kontroll për kapjen e ndotësve të ajrit**, se përdorimi i lëndëve djegëse të cilat nga djegia dhe mosushtrimi i kontrollit ndaj tyre, **kanë lëshuar në ajër gazra e tymra me përmbajtje të lartë të ndotjes mjedisore, se ndotja e konstatuar disa herë më e lartë se kufijtë e lejuar të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë**. Gjykata ka argumentuar gjithashtu se, ndotja është e dëmshme për shëndetin e punonjësve dhe banorëve që preken nga gazet të cilat shkaktojnë irritime në rrugët e sipërme të frymëmarrjes, ndërsa bloza e lëshuar në ajër nga djegia është në mënyrë të sigurtë pranuar edhe nga OBSH, si kancerogjene.

Dokumentacioni i studiuar nga KShH evidenton se, është e paqartë nëse veprimtaria goditëse e organeve të ndjekjes dhe gjykimit penal ka patur në shënjestër pikërisht organizatorët ose “pronarët” e aktivitetit të furrave gëlqerorë apo thjeshtë punonjësit e tyre. Përsëritja në mënyrë të vazhdueshme e kësaj veprimtarie përgjatë periudhës 2 vjet e tre muaj, objekt i këtij raporti studimor, të bën të dyshosh se fenomeni i ndëshkueshmërisë ka prekur më së shumti hallkat e fundit të kësaj veprimtarie ndërkohë që nuk ka patur ndëshkueshmëri të personave që drejtojnë dhe organizojnë punën në furrat gëlqerore. Në këtë vështrim, ka arsye të dyshohet për njëanshmëri ose mungesë objektiviteti të shqyrtimit të këtyre çështjeve.

2.2 Mbi gjetjet nga analiza e vendimeve të prokurorisë

Studimi i vendimeve të prokurorisë evidenton se, veprimtaritë e furrave gëlqerore kanë qenë tepër aktive, aq sa organet e policisë apo të inspektimit të mjedisit kanë vërejtur ushtrimin intensiv të kësaj veprimtarie gjatë kontrolleve apo verifikimeve në terren. Ky konstatim evidenton një shpërfillje ndaj organeve ligjzbatuese dhe autoritetit shtetëror nga “pronarët” apo personat që drejtojnë dhe organizojnë veprimtarinë e këtyre furrave. Konkretisht, në 9 nga 11 vendimet e Prokurorisë rezulton se, në momentin e konstatimit të aktivitetit të prodhimit të gëlqeres nga ana e organeve të policisë apo inspektoriatit të mjedisit, furra ka qenë duke djegur lëndët djegëse, disa prej të cilave paraqesin rrezikshmëri të lartë për ndotjen e mjedisit si goma të përdorura, materiale sfungjeri, mbetje të stabilimentit të sharrave, etj.

Në 11 vendime të prokurorisë për mosfillim të procedimit penal apo pushim të çështjes, rezulton se Akti i Ekspertimit tekniko-mjedisor është kryer kur furra e gëlqeres nuk ka qenë duke e ushtruar aktivitetin e saj, duke djegur lëndët djegëse. Në të gjitha rastet, aktet e ekspertimit për matjen e nivelit të ndotjes së ajrit nuk janë realizuar në të njëjtën datë që është konstatuar fakti, por pas disa ditësh apo javësh, kur ndotja është minimizuar për shkak të pushimit të veprimtarisë së furrës. Distanca kohore ndërmjet konstatimit të ngjarjes së paligjshme dhe realizimit të matjes së cilësisë së ajrit, variojnë nga 5 ditë deri në 5 muaj e 2 ditë. Mesatarja e këtij intervali kohor është 1 muaj e 6 ditë. Këto të dhëna krijojnë dyshime të arsyeshme se kjo praktikë tolerance mund të ketë qenë e qëllimshme.

Mosrealizimi i Aktit të Ekspertimit tekniko-mjedisor gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së furrave vlerësojmë se ka ndikuar në mosekzistencën e një nga elementëve të anës objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 201, i Kodit Penal, që kërkon që ndotja e ajrit të jetë **tej kufirit të normave të lejuara**. Vendimet e prokurorisë të studiuara evidentojnë se, Prokurori ka vendosur pushimin e çështjes penale në 9 raste dhe mosfillimin e procedimit penal në 2 raste, për shkak se, **bazuar në matjet sipas Aktit të Ekspertimit tekniko-mjedisor nuk është konstatuar ndotje e ajrit (nga çlirimi i gazrave dhe grimcave) mbi normat e lejuara që parashikohen në VKM nr. 803, dt. 04.12.2003, “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”**. Nëse Akti i Ekspertimit tekniko-mjedisor nuk mund të realizohej në momentin e konstatimit të shkeljes, do të kish qenë e rekomandueshme që organi procedues, prokuroria të vendosë kryerjen e eksperimentit konform neneve 176 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale. Në kushtet e eksperimentit, ose siç njihet ndryshe riprodhimit, për aq sa është e mundur, i gjendjes në të cilën fakti ka ndodhur ose çmohet se ka ndodhur, mund të realizohej edhe matja në mënyrë objektive dhe sa më afër realitetit, e nivelit të ndotjes me anë të ekspertimit tekniko-mjedisor.

Në të gjitha vendimet nuk rezulton që, organi i Policisë që ka konstatuar aktivitetet e furrave apo organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, që ka hetuar këto aktivitete nuk kanë verifikuar nëse subjektet ushtronin aktivitetin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, për sa i takon lejeve (leje mjedisore, leje shfrytëzimi, etj), mbrojtjes së mjedisit, zbatimit të Kodit të Punës, etj. Megjithatë, në ndryshim nga praktika hetimore e prokurorisë, në praktikën gjyqësore, vihet re në disa raste se gjykata ka analizuar faktin se, veprimtaria e ushtruar nga i pandehuri është e jashtëligjshme dhe mungon leja përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

Për të forcuar ndëshkueshmërinë e veprimeve të rrezikshme që dëmtojmë mjedisin, do të ishte i rekomandueshëm rishikimi i nenit 201 të Kodit Penal. Sipas këtij neni, ushtrimi i veprimtarisë pa licencë nuk përbën një element të anës objektive të kësaj figure të veprës penale. Në paragrafin e parë të nenit 201, parashikohet se një nga elementët bazë të figurës së veprës penale është ndotja tej normave të lejuara dhe fakti që nuk përbën kundravajtje administrative. Në paragrafin e dytë parashikohet e njëjta vepër por me dënim më të ashpër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve. **Në këtë drejtim, vlerësojmë se mund të rishikohet neni 201, paragrafi i parë i Kodit Penal, për të parashikuar si element të veprës penale kryerjen e veprës në mënyrë të përsëritur dhe pa lejet përkatëse nga organet kompetente, kur më parë janë marrë masa administrative.** Rishikimi i kësaj dispozite vlerësojmë se do të rrisë efektshmërinë e organeve të ndjekjes penale në parandalimin dhe luftën ndaj kësaj vepre penale.

Materialet e vëna në dispozicion nga prokuroria të çojnë në konkluzionin përgjithësues se, hetimi i kryer nga prokuroria nuk ka qenë i plotë, i shpejtë, efektiv dhe i gjithëanshëm, por është bazuar në materialet e dërguara nga Komisariati i Policisë Krujë dhe është shtrirë deri në kryerjen e Aktit të Ekspertimit tekniko-mjedisor. Nuk rezulton që hetimet të jenë shtrirë në drejtim të pyetjes së - palëve private, kryerjes së ballafaqimeve, marrjes dhe sigurimit të provave materiale, etj.

Në asnjë rast, nuk rezulton të jenë pyetur banorë të zonës që mund të kenë dijeni për ngjarjen në këto zona dhe që preken apo dëmtohen drejtpërsëdrejti nga ndotja e mjedisit. Në këtë drejtim hetimet nuk kanë qenë të plota edhe për faktin se, sipas paragrafit të dytë të nenit 201, po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin dhe jetën e njerëzve, dënohet me burgim gjer në 10

vjet. Në asnjë nga çështjet objekt i këtij studimi nuk është hetuar nga prokuroria nëse ka patur dëmtim në shëndetin dhe jetën e njerëzve si rrjedhojë e ndotjes së shkaktuar nga furrat gëlqerore. Ky konstatim është tepër shqetësues në drejtim të mungesës së ndëshkueshmërisë së kësaj vepre penale, konform nenit 201, paragrafi 2, i Kodit Penal.

Gjithashtu, u konstatua një mungesë e theksuar e mbikëqyrjes dhe inspektimit të veprimtarisë së furrave gëlqerore, nga organet e ngarkuara me përgjegjësi administrative për mbrojtjen e mjedisit dhe ajrit si element esencial i tij.

Në vendimet e saj, Prokuroria paraqet në mënyrë të detajuar faktet dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, por nuk pasqyron në mënyrë të detajuar analizën për elementët e figurës së veprës penale dhe në mënyrë të veçantë, anën objektive dhe subjektive e figurës së kësaj vepre si dhe lidhjen shkakësore si moment i domosdoshëm për përcaktimin e përgjegjësisë penale. Në procedime të ndryshme penale për të njëjtën vepër penale të lidhur me furrat gëlqerore, prokuroria, edhe pse kryen të njëjtat veprime hetimore, nuk ndjek një praktikë të unifikuar për vendimmarrjen. Konkretisht, në 9 raste ka vendosur pushim të çështjes penale dhe në 2 raste mosfillim të procedimit penal.

Në rastet kur prokuroria ka vendosur pushimin e çështjes penale, afatet e hetimit variojnë nga 27 ditë deri në 5 muaj e 8 ditë. U konstatua se, **7 prej procedimeve penale** janë hetuar **brenda afatit 3 muajor** dhe 2 procedime janë hetuar respektivisht, për 4 muaj e 22 ditë dhe për 5 muaj e 8 ditë. Në rastet kur është vendosur mosfillim i procedimit penal, afatet e veprimeve hetimore kanë zgjatur 18 ditë deri në 2 muaj.

Në 11 raste, prokuroria ka përcaktuar në vendim njoftimin e palëve të interesuara por vetëm në 1 rast është cituar shprehimisht si palë e interesuar, Komisariati i Policisë Krujë. Në të gjitha vendimet është cituar e drejta e palëve të interesuara për t'iu drejtuar gjykatës.

Në informacionet e sjella nga policia dhe prokuroria, nuk rezulton të jenë ankimuar nga Komisariati i Policisë Krujë asnjë nga vendimet e prokurorisë në rrugë gjyqësore apo tek prokurori më i lartë. Policia legjitimohej t'i ankimonte këto vendime dhe në vlerësimin tonë, mosushtrimi i kësaj të drejte është tepër shqetësues dhe ka ndikuar në rritjen e pandëshkueshmërisë së këtij aktiviteti të dëmshëm ndaj mjedisit dhe jetës e shëndetit të banorëve në fshatrat e Bashkisë Krujë.

2.3 Mbi gjetjet nga analiza e vendimeve gjyqësore

Në periudhën që është në fokus të këtij raporti studimor rezulton se, për 14 çështje penale, organi i prokurorisë ka ngritur akuzën në gjykatë ndaj disa të pandehurve, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 201, i Kodit Penal. **Rrjedhimisht vërehet se, pak më shumë se gjysma e çështjeve penale të hetuara nga prokuroria për veprimtarinë e furrave gëlqerore, janë dërguar me akuzë penale për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, si gjykatë kompetente nga pikëpamja lëndore dhe territoriale.**

Në 13 prej rasteve të dërguara nga prokuroria në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, të pandehurit e akuzuar janë deklaruar fajtor dhe janë dënuar për veprën penale të “Ndotjes së ajrit”. Kjo shifër evidenton një nivel të lartë ndëshkueshmërie nga gjykata, ku vetëm për një çështje është pushuar

gjykimi për shkak të zbatimit të ligjit të aministisë. Në të 13 rastet kur gjykimi ka përfunduar me dënim të të pandehurve, gjykata ka pranuar gjykimin e shkurtuar, çka ka rezultuar me një ulje në mënyrë automatike të dënimeve me burg ose me gjobë.

Në 13 vendimet gjyqësore të sipërpërmendura, **prova kryesore për dënimin e të pandehurve është Akti i Ekspertimit tekniko-mjedisor**, i cili është kryer në kushtet e ushtrimit të aktivitetit të furrave gëlqerore. Nga ky akt ka rezultuar se, ndotja e shkaktuar nga çlirimi i gazrave dhe pluhurave gjatë djegies ka tejkaluar normat e lejuara në VKM nr. 803, dt. 04.12.2003, “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”.

Akti i Ekspertimit tekniko-mjedisor vlerësohet një nga provat më kardinale në proceset hetimore dhe gjyqësore për veprën penale të parashikuar nga neni 201, i Kodit Penal. Moskryerja e Aktit të Ekspertimit tekniko-mjedisor në momentin e konstatimit të aktivitetit/punës në furrat e gëlqerës, ka çuar në mosfillimin e procedimit penal apo pushimin e çështjes penale nga prokuroria. Ndërsa, kur Akti i Ekspertimit tekniko-mjedisor është kryer në kohën e duhur, kur furra e gëlqerës ka qenë në punë duke çliruar gazrat dhe pluhurat në mjedis, çështja penale është dërguar për gjykim nga prokuroria dhe gjykata ka deklaruar fajtor të pandehurit për veprën penale “Ndotje e ajrit”.

Vonesa në kryerjen e aktit të ekspertimit ka ndikuar në zbardhjen e ngjarjeve dhe verifikimin shkencor të ndotjes mjedisore, **duke ulur ndëshkueshmërinë** e rasteve të cënimit të së drejtës për mjedis të pastër dhe jetë të shëndetshme.

Përgjithësisht, në vendimet gjyqësore vërehet se ka analizë nga pikëpamja formale të elementëve të figurës së veprës penale. Megjithatë, shpesh herë analiza nuk është e thellë. Në ndryshim nga vendimet e prokurorisë, në 5 vendime gjyqësore u konstatua se gjykatat kanë konkluduar se veprimtaria e ushtruar nga i pandehuri është e jashtëligjshme dhe mungon leja përkatëse për ushtrimin e aktivitetit. Në pjesën më të madhe të vendimeve, gjykata shprehet se janë kryer veprime të kundërligjshme duke mos u ndaluar konkretisht në analizën e kundërligjshmërisë së veprimtarisë për të cilin është zhvilluar procesi gjyqësor penal.

U konstatua se, nga 15 të pandehur që janë gjykuar me akuzën e veprës penale të “Ndotjes së ajrit”, 14 prej tyre kanë qenë të padënuar më parë. Kjo e dhënë tërheq vëmendjen, në kushtet kur veprimtaria e furrave gëlqerore ka qenë e përsëritur dhe shqetësuese gjatë gjithë periudhës mbi të cilën është realizuar ky raport studimor. Në raport me faktin që ky fenomen ka qenë i përsëritur, diskutimi që shtrohet sërish (sikurse është përmendur edhe më sipër) është se, cilët janë personat që janë marrë si të pandehur, nëse janë ata që kanë qenë të angazhuar me vënien në përdorim të këtyre furrave (punëtorët) apo nëse kanë qenë pronarët apo organizatorët e këtyre veprimtarive.

3 Metodologjia

Metodologjia që është ndjekur për hartimin e këtij raporti është bazuar në përpunimin sasior dhe cilësor të informacionit që është vënë në dispozicion me dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Prokuroria dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Studimi ka patur në fokus vendimet e Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për veprën penale “Ndotje e ajrit”, parashikuar nga Neni 201, i Kodit Penal. Periudha në të cilën shtrihet studimi është Janar 2015 – Mars 2017 dhe i referohet rasteve specifike që kanë të bëjnë me procedimet dhe gjykimet penale të lidhura me furrat gëlqerore në fshatrat e Bashkisë Krujë.

Me Shkresën nr. 60/1, dt. 09.05.2017, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë ka dërguar kopje të vendimeve për periudhën kohore Janar 2015 – Mars 2017, lidhur me hetimin e veprës penale “Ndotja e ajrit”, parashikuar nga neni 201, i Kodit Penal. Ndërsa, me Shkresën nr. 152, dt 08.08.2017, janë dërguar kopjet e vendimeve gjyqësore për çështjet e gjykuara për Nenin 201, të Kodit Penal për periudhën kohore Janar 2015 – Mars 2017.

Gjithashtu, me anë të Shkresës nr. 3075/4, dt. 12.07.2017, “*Kthim përgjigje*”, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës ka informuar lidhur me verifikimin dhe ndjekjen e kësaj problematike nga kjo Drejtori, si dhe është dërguar dokumentacion i disa subjekteve gurore dhe furrave të djegies që ushtrojnë aktivitetet në rrethin e Krujës.

Me qëllim realizimin e Studimit, u morën në analizë **9 vendimet e pushimit** dhe **2 vendimet e mosfillimit** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Krujë, dhe **13 vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë**.

Grupi i punës i angazhuar për përgatitjen e studimit evidentoi drejtimit kryesore ku do të përqendrohej studimi, duke u bazuar edhe në metodologjinë e ndjekur nga KShH për studime të mëparshme për pandëshkueshmërinë e veprave penale në fushën e korrupsionit apo studime të tjera të vendimeve të prokurorisë dhe vendimeve gjyqësore penale. E veçanta e këtij raporti studimor tematik, në raport me studimet tona të tjera është se lidhet me një veprimtari të përsëritur kriminale që shtrihet në fushën e mjedisit. Studimi dhe krahasimi i të dhënave u realizua në një analizë gjithëpërfshirëse dhe objektive në raport me kuadrin ligjor në fuqi, duke përfshirë edhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e mjedisit.

4 Analizë e kallëzimeve penale dhe vendimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë

4.1 Veprimtaria e Policisë së Krujës dhe bashkëpunimi me autoritetet vendore

Referuar informacionit të ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë Krujë, rezulton se për periudhën Janar 2015 – Mars 2017 nuk ka patur asnjë kallëzim penal nga qytetarë apo organet e ngarkuara me përgjegjësi në fushën e mbrojtjes dhe inspektimit të mjedisit, lidhur me kryerjen e veprave penale kundër mjedisit dhe veçanërisht për veprën penale “Ndotja e ajrit”, parashikuar në nenin 201, të Kodit Penal.

Ndotja e mjedisit është një fenomen mjaft i dëmshëm dhe shqetësues për shkak se sjell pasoja të drejtpërdrejta në jetesën e individëve si burim i sëmundjeve të ndryshme. Çelja, ndërprerja dhe rivënia në funksion e furrave gëlqerore në disa zona të Bashkisë Krujë, por kryesisht në Burizanë, edhe pse ka çuar në ngritjen e shqetësimit të banorëve në media, në asnjë rast (sipas dokumentacionit të administruar nga KShH), nuk u konstatua që procedimi penal të ketë filluar në bazë të kallëzimit të bërë nga qytetarët. Kjo tregon një nivel të ulët ndërgjegjësimi publik dhe të besimit të tyre në ndëshkueshmërinë e rasteve të tilla që përbëjnë rrezik real për shëndetin dhe jetën e tyre private e familjare.

Gjithashtu, autoritet vendore që kanë për detyrë të sigurojnë ruajtjen dhe zhvillimin e ambientit, duhet të bashkëpunojnë me organet e Policisë së Shtetit me qëllim mbrojtjen e komunitetit nga veprimet e paligjshme dhe dëmet e rënda në mjedis dhe në shëndetin e popullatës. Sipas nenit 281, të Kodit të Procedurës Penale, pikat 1, 2 dhe 3, *“1. Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale. 2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore. 3. Kur, gjatë një procedimi civil ose administrativ, zbulohet një fakt që përbën vepër penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim te prokurori.*

Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, ndër të tjera informon se, gjatë kësaj periudhe, nga ana e Komisarariatit të Policisë Krujë janë kryer operacione të përbashkëta me Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Durrës, Policinë Bashkiake për prishjen e gropave dhe furrave të djegies së gëlqeres.

Drejtoria Vendore e Policisë Durrës ka konstatuar 28 raste të kryerjes së kësaj vepre penale. Në çdo rast janë referuar materialet përkatëse në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë. Rastet e denoncuar kanë përfshirë 37 persona të dyshuar, nga të cilët, 29 janë hetuar në gjendje të lirë ndërsa 8 persona janë hetuar me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Kjo Drejtori informon se, në Bashkinë Krujë ushtrojnë aktivitet si shoqëri tregtare disa subjekte gurore dhe dy subjekte furra të djegies së gëlqeres, të cilat janë të pajisura me lejet përkatëse (leje shfrytëzimi, leje mjedisore, etj), të lëshuara nga ministritë e linjës dhe janë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Licensimit si subjekte të tatueshme.

Megjithatë, në informacionin zyrtar të përcjellë pranohet se nga kontrollat e ushtruara nga Komisarati i Policisë Krujë janë konstatuar disa subjekte që ushtrojnë aktivitet të paligjshëm të

djegies së gëlqeres dhe ndaj tyre është filluar ndjekja penale dhe materialet janë referuar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vlen të evidentohet se, për të njëjtën periudhë vlerësimi u **konstatua mospërputhje të numrit të rasteve të kryerjes së veprës penale “Ndotja e ajrit”**, të referuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës (28 raste), me numrin e procedimeve penale të hetuara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe të rasteve të gjykuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë (gjithsej 25 raste).

4.2 Subjektet që kanë iniciuar procesin penal

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka studiuar 9 vendimet e pushimit të çështjes penale dhe 2 vendimet e mosfillimit të procedimit penal të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, gjatë periudhës kohore Janar 2015 – Mars 2017.

Në 11 vendimet e studiuara, rezultoi se çështjet janë referuar nga Komisarati i Policisë Krujë pranë Prokurorisë së Rrethit gjyqësor Krujë. Në 1 prej këtyre vendimeve për të cilën është marrë vendim pushimi, fakti i shkeljes është konstatuar nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Durrës, në bashkëpunim me policinë gjyqësore të Komisaritit të Policisë Krujë dhe është referuar nga ky i fundit në prokurori. Ndërkohë që në total, në 3 raste Komisarati i Policisë Krujë ka bashkëpunuar me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Durrës. Në asnjë rast tjetër nuk rezultoi që, Inspektorati Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Durrës apo Bashkia Krujë të kenë denoncuar ndërhyrjet negative që kanë dëmtuar mjedisin, të kryera nga shtetasit apo subjektet e ndryshme. Sipas nenit 62, të Ligjit nr. 10 431, dt. 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, Inspektorati Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Durrës ka detyrim ligjor për të siguruar kontrollin për mbrojtjen e mjedisit, ndërkohë që sipas nenit 26, pika 1 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Bashkitë (Bashkia Krujë) janë përgjegjëse për sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.

Vetëm në një rast salla operative e Komisaritit të Policisë Krujë është njoftuar për veprimtarinë e furrës gëlqerore nëpërmjet aplikacionit të quajtur “Komisarati dixhital”.

4.3 Veprimet dhe afatet hetimore

Veprimet dhe afatet hetimore janë analizuar konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që ka qenë në fuqi në kohën e studimit dhe jo ndryshimeve në këtë Kod,, të miratuara në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Në nenin 323, të Kodit të Procedurës Penale parashkohej se: *“Brenda tre muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj. Kur është i nevojshëm autorizimi i procedimit, ecja e afatit pezullohet nga çasti që bëhet kërkesa deri në ditën kur autorizimi i vjen prokurorit.”*

Referuar në 9 vendimet e pushimit të procedimit penal, afatet e hetimit variojnë nga 27 ditë deri në 5 muaj e 8 ditë. U konstatua se 7 prej procedimeve penale janë hetuar brenda afatit 3

mujor dhe 2 procedime janë hetuar respektivisht për 4 muaj e 22 ditë dhe për 5 muaj e 8 ditë. Në total, mesatarja e afateve të hetimit ka zgjatur afërsisht 2 muaj e 4 ditë. Në nenin 324, të Kodit të Procedurës Penale parashikohej se, prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj duke marrë vendim. **Nga informacioni që disponojmë duke u referuar vetëm tek vendimet, nuk ishte e mundur të konstatohej nëse është marrë ndonjë vendim për zgjatjen apo pezullimin e afatit hetimor.**

Sa i takon afateve të realizimit të veprimeve hetimore për procedimet penale të cilat janë mosfilluar nga Prokuroria, rezulton se kanë zgjatur 18 ditë deri në 2 muaj.

Duke u referuar tek veprimet hetimore të kryera nga prokuroria, përgjithësisht, rezulton të jenë marrë në pyetje personat ndaj të cilëve është regjistruar procedimi penal, deklaratimet e personave të tjerë që janë konstatuar në vendngjarje, si dhe është kryer Akti i Ekspertimit. Referuar informacionit të pasqyruar në vendim, **në asnjë rast, nuk rezulton të jenë pyetur familjarë apo banorë të zonës që mund të kenë dijeni për ngjarjen në këto zona dhe që preken apo dëmtohen drejtpërsëdrejti nga ndotja e mjedisit.**

Në 9 nga 11 vendimet e Prokurorisë rezulton se, në momentin e konstatimit të aktivitetit të prodhimit të gëlqeres nga ana e organeve të policisë apo inspektoratit të mjedisit, furra ka qenë në gjendje pune, duke djegur lëndët djegëse të tilla si, *goma të përdorura, lëndë djegëse dërrasa, pjesë mobilie, divaneve, materiale sfungjeri, etj., mbetje të stabilimentit të sharrave, etj.*

Në të gjitha rastet, Aktet e Ekspertimit për matjen e nivelit të ndotjes së ajrit nuk janë realizuar në të njëjtën datë që është konstatuar fakti i paligjshëm, por pas disa ditësh apo javësh. Për pasojë nuk është konstatuar ndotje dhe në mungesë të pasojave të dëmshme, çështja penale është pushuar ose është vendosur mosfillim i procedimit penal. Sa i takon distancës kohore ndërmjet datës ku është konstatuar ngjarja dhe realizimit të matjeve të ajrit përmes Aktit të Ekspertimit, janë: 5 muaj e 2 ditë, 2 muaj e 10 ditë, 1 muaj e 14 ditë, 6 ditë, 1 muaj e 13 ditë, 2 muaj e 22 ditë, 22 ditë, 1 muaj e 16 ditë, 1 muaj e 12 ditë, 1 muaj e 10 ditë dhe 5 ditë. Sikurse paraqitet, distanca kohore varion nga 5 ditë deri në 5 muaj e 2 ditë. Mesatarja e distancës kohore ndërmjet konstatimit të ngjarjes dhe matjeve të nivelit të ndotjes së ajrit është 1 muaj e 6 ditë, çka përbën një periudhë tepër të gjatë.

Studimi i vendimeve evidenton se, shtetasit përdorin furrat gëlqerore për shkak të nevojës ekonomike ndërkohë që të tjerë kanë mohuar që furra gëlqerore ju përket atyre. Në një rast është cituar se veprimtaria që ushtronte subjekti i proceduar penalisht, ishte konform lejes së ambientit të dhënë nga Ministria e Mjedisit dhe licencës së dhënë nga Bashkia Krujë, duke cituar dhe emrin e personit i cili ka kryer monitorimin e ajrit, i cili është i certifikuar pranë Qendrës së Monitorimit të Mjedisit. **Në asnjë rast, nuk rezulton të jetë hetuar ligjshmëria ose jo e ushtrimit të aktivitetit duke marrë dhe administruar të dhëna apo dokumente konkrete për lejen dhe të licencën.**

Në asnjë rast nuk u konstatua caktimi i masës së sigurisë “*Arrest në burg*”, për shtetasit ndaj të cilëve zhvilloheshin hetimet. Në një rast u konstatua se ishte vendosur sekuestro preventive mbi gropën e gëlqeres, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, duke treguar nevojën për unifikimin e praktikës hetimore dhe gjyqësore në të njëjtin rreth gjyqësor për çështje të së njëjtës natyrë.

4.4 Analiza e shkaqeve për mosfillimin e procedimit penal dhe të pushimin e çështjeve penale

Në nenin 328, të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) i dëmtuari nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.”

Gjithashtu bazuar në nenet 290 dhe 291, të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se, *procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur: a) personi ka vdekur; b) personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale; c) mungon ankimi i të dëmtuarit ose ai e tërheq ankimin; ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston; d) vepra penale është shuar; dh) është dhënë amnisti; e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.* Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit.

Në vendimet e pushimit të çështjes, ashtu dhe në vendimet e mosfillimit, organi i Prokurorisë argumenton pushimin ose mosfillimin e çështjes për shkak se fakti i ndodhur nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Në **9 vendimet e pushimit** rezulton se, Prokuroria ka analizuar rrethanat e faktit dhe argumenton pushimin e akuzës ose të çështjes për shkak se, fakti i ndodhur nuk parashikohet nga ligji si vepër penale në kushtet **ku kërkohet që të ketë ndotje faktike të ajrit dhe mjedisit rrethues**. Nga realizimi i Aktit të Ekspertimit tekniko-mjedisor pas konstatimit të ngjarjes, nga matjet përkatëse ndotja e ajrit nuk ka rezultuar mbi normën e lejuar siç parashikohet në VKM nr. 803, datë 04.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”.

Në **2 vendimet e mosfillimit**, organi i Prokurorisë ka analizuar rrethanat e faktit duke u bazuar në konkluzionet e Aktit të Ekspertimit tekniko-mjedisor, duke referuar se parametrat e cilësisë së ajrit janë në përputhje me VKM-në e cituar më sipër. Për këtë shkak ka rezultuar se, nuk ka ndotje faktike të ajrit dhe në bazë të nenit 290/ç, të Kodit të Procedurës Penale është vendosur mosfillimi i çështjes për shkak se fakti i mësipërm nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Në këto vendime rezulton se paraqiten në mënyrë të detajuar faktet dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja e denoncuar. Megjithatë, arsyeja ose shkak mbi të cilin Prokuroria ka bazuar mosfillimin e procedimit penal apo pushimin e çështjes penale ose akuzës, si dhe **orientimi i kufizuar i Prokurorisë në kryerjen e veprimeve hetimore apo vonesa në kryerjen e Aktit të Ekspertimit, evidenton se hetimet nuk kanë qenë të shpejta, të plota dhe të gjithëanshme.**

4.5 Respektimi i të drejtës së ankimit për vendimet e prokurorisë

Në nenin 291, të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “Vendimi i mosfillimit u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit”. Referuar nenit 329/1, të këtij Kodi parashikohet se: “Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri. Ndërsa, Neni 24/4,5 i Kodit parashikonte se: “...Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët. Prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim ose kryesisht”.

Në 11 vendime, Prokuroria ka vendosur njoftimin e palëve të interesuara dhe vetëm në 1 nga këto raste është cituar shprehimisht njoftimi i Komisarariatit të Policisë Krujë. Në të gjitha vendimet është cituar e drejta e palëve të interesuara për t’iu drejtuar gjykatës, ku në 5 nga këto raste janë parashikuar afatet brenda të cilave mund të ushtrohet e drejta e ankimit dhe në 1 nga këto vendime është parashikuar gjithashtu dhe e drejta e ankimit tek prokurori më i lartë.

Në informacionet e sjella nga policia dhe prokuroria, nuk rezulton të jenë ankimuar nga Komisaritati i Policisë Krujë asnjë nga vendimet e prokurorisë në rrugë gjyqësore apo tek prokurori më i lartë. Kjo ka ndikuar në rritjen e pandëshkueshmërisë së këtij aktiviteti të dëmshëm ndaj mjedisit dhe jetës e shëndetit të banorëve.

E drejta e ankimit është një nga standardet e procesit të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore e sanksionuar në Kushtetutë dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të njeriut. Njëkohësisht, ushtrimi i kësaj të drejte garanton kontrollin gjyqësor mbi organet e hetimit në procesin penal.

Në rastin e vendimeve të mosfillimit të procedimit penal, Kodi i Procedurës Penale ia njëhte këtë të drejtë shprehimisht personit fizik/juridik që ka bërë kallëzimin dhe që në rastin konkret është Komisaritati i Policisë Krujë. Në rastin e vendimeve të pushimit të akuzës ose të çështjes penale, Kodi i Procedurës Penale ia njëhte të drejtën e ankimit, të dëmtuarit. Të dëmtuar për këto çështje janë jo vetëm banorët, të cilët preken drejtpërsëdrejti nga ndotja e mjedisit por është edhe shteti, i cili përfshin një sërë organizmash përgjegjëse për parandalimin dhe goditjen e kriminalitetit, duke përfshirë edhe ato në fushën e mjedisit. Policia është e ngarkuar me përgjegjësi të shumta në drejtim të parandalimit dhe goditjes së kriminalitetit dhe rrjedhimisht, në vlerësimin tonë ajo paraqitet, në cilësinë e të dëmtuarit dhe duhet të ushtronte të drejtën e ankimit.

5 Analizë e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë

5.1 Subjektet që kanë iniciuar procesin

Në nenin 280, të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *“Prokurori dhe policia marrin dizeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët”*.

Nga studimi i përmbajtjes së 14 vendimeve gjyqësore rezultoi se, 9 procedime penale janë iniciuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë. Megjithatë vihet re një mospërputhje e statistikave dhe e të dhënave të vëna në dispozicion nga policia me ato të vendimeve gjyqësore të studiuara, lidhur me mënyrën e vënies në lëvizje të prokurorisë. Kjo pasi, sipas të dhënave të Policisë, janë konstatuar 28 raste të kryerjes së kësaj vepre penale dhe në çdo rast është bërë referimi i materialeve përkatëse në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë. Pra, edhe për këto 9 procedime penale, për të cilat sipas vendimeve gjyqësore evidentohet se Prokuroria është vënë në lëvizje me insiativën e saj, mundet që pjesërisht mund të jenë referuar nga Komisariati i Policisë Kruje.

Në 4 vendime gjyqësore rezulton shprehimisht se, vepra penale është referuar në Prokurori nga Komisariati i Policisë Krujë dhe në 1 vendim gjyqësor, ku çështja është pushuar për shkak se i pandehuri ka përfituar nga amnistia, nuk del në pah organi i cili ka vënë në lëvizje Prokurorinë.

5.2 Masat shtrënguese për të pandehurit

Referuar 14 vendimeve gjyqësore të studiuara rezulton se, në total janë proceduar penalisht me cilësinë e të pandehurit 15 shtetas. Për 12 të pandehur është dhënë masa shtrënguese *“Detyrim për paraqitje pranë oficerit të policisë gjyqësore”*, ose *janë gjykuar në gjendje të lirë*, sikurse parashikon neni 234, i Kodit të Procedurës Penale. Për 3 të pandehur të tjerë, **në vendim nuk pasqyrohet nëse ndaj tyre janë aplikuar masa shtrënguese.**

5.3 Procedimi me gjykim të shkurtuar

Në nenin 403 e vijues të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar instituti juridik i gjykimit të shkurtuar, i cili, sipas Kodit të Procedurës Penale është gjykim i posaçëm. Gjykimi i shkurtuar ka si synim shmangien e një procedure të zakonshme gjyqësore, dhe gjykata operon në gjendjen që ndodhen aktet e marra gjatë hetimit nga prokuroria. Gjykimi i shkurtuar sjell përfitime në drejtim të ekonomisë gjyqësore dhe, nëse të pandehurit deklarohen fajtor, mundëson uljen e dënimit me burgim ose me gjobë, në mënyrë automatike me 1/3 e dënimit.

Nga vendimet gjyqësore të studiuara rezulton se, në të gjitha rastet, të pandehurit kanë kërkuar gjykim të shkurtuar dhe gjykata e ka pranuar atë. **Në përfundim të proceseve gjyqësore të realizuar me gjykim të shkurtuar, personat e pandehur janë shpallur fajtor nga gjykata dhe kanë përfituar ulje të dënimit.** Gjatë parashtrimit të kërkesave paraprake, të pandehurit i kanë kërkuar Gjykatës aplikimin e gjykimit të shkurtuar, duke ndjekur kërkesat e ligjit për procedurën e nevojshme që duhet të zbatohet në drejtim të ekonomisë së gjykimit. Gjykata ka vendosur në çdo rast pranimin e Kërkesës duke u shprehur se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet por që më pas ka rezultuar me fajësinë e të pandehurve.

Në një pjesë të vendimeve, Gjykata ka cituar Vendimin Unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku arsyetohet se, gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm që eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Në këto kushte dosja e prokurorit kthehet në fashikull gjyqësor, duke marrë vlerën e provës pas pranimit të Kërkesës për gjykim të shkurtuar.

5.4 Arsyetimi i vendimeve gjyqësore

Referuar neneve 382 dhe 383, të Kodit të Procedurës Penale rezulton se, pasi merret vendimi, arsyetohet duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues. Vendimi duhet të përmbajë gjykatën që e ka dhënë, gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejnë për ta identifikuar, si dhe gjeneralitetet e palëve të tjera private në rast se ka, akuzën, parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit, datën si dhe nënshkrimin anëtarëve të trupit gjykues.

Nga studimi i 14 vendimeve gjyqësore rezulton se, për shkak se është proceduar me gjykim të shkurtuar, gjykata është bazuar në provat e marra gjatë hetimit paraprak të kryer nga organi i akuzës si: Akti i Ekspertimit teknio-mjedisor, sekuestrimet e lëndëve djegëse, këqyrja e vendodhjes së furrës gëlqerore, referimi në materialet fizike të konstatuara pranë ambientit, pyetja e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personave që kanë dijeni për ngjarjen, etj.

Në përgjithësi rezulton se, gjykata analizon në mënyrë të përmbledhur faktet duke u referuar në provat e sipërcituar dhe kryesisht në Aktin e Ekspertimit tekniko-mjedisor. Kjo për shkak se, në bazë të rezultateve të këtij AktiEkspertimi është argumentuar konsumimi ose jo i elementëve të figurës së veprës penale të parashikuar në Nenin 201, të Kodit Penal. Sipas gjykatës, që të gjendemi përpara faktit të ndotjes së mjedisit, është e nevojshme që niveli i ndotjes të rezultojë mbi normat e parashikuara në VKM nr. 803, datë 04.12.2003, të cituar më sipër.

Bazuar në Aktin e Ekspertimit, Gjykata ka argumentuar se, teknologjia primitive e prodhimit të gëlqerës në furra nuk mundëson kontroll për kapjen e ndotësve. Përdorimi i lëndëve djegëse të cilat nga djegia dhe mos kontrolli i kapjes së tyre kanë lëshuar në ajër gazra e tymra me përmbajtje të lartë të ndotjes mjedisore. Ndotja e konstatuar disa herë më e lartë se kufijtë e lejuar të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë është e dëmshme për shëndetin e punonjësve dhe banorëve që preken nga gazet të cilat shkaktojnë irritime në rrugët e sipërme të frymëmarrjes, ndërsa bloza e lëshuar në ajër nga djegia është në mënyrë të sigurtë pranuar edhe nga OBSH, si kancerogjene. Në këtë nivel ndotje vihet në rrezik ekuilibri natyror mjedisor, për natyrën (faunën dhe florën) përreth.

Vlen të përmendet se, sipas jurisprudencës së GjEDNj, ndotja mund të çënojë jetën private dhe familjare⁴ të një personi ose mirëqenien e tij/saj dhe shteti ka për detyrë të sigurojë mbrojtjen e qytetarëve duke rregulluar, autorizuar, ngritur, funksionimin e sigurisë dhe monitorimin e aktiviteteve industriale, veçanërisht aktivitetet që janë të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e

⁴ Neni 8, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut

njeriut.⁵

Në çështjen *Dubetska dhe të tjerë kundër Ukrainës*, GjEDNJ u shpreh se mund të shkelet Neni 8, i Konventës “e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare” në rast se, **një ndotje mjedisore është e një niveli të tillë rrezikshmërie që rezulton në dëmtime të konsiderueshme të aftësisë së ankuesit që të gëzojë shtëpinë, jetën e tij/saj private apo familjare**. Vlerësimi i nivelit të shkeljeve është relativ dhe varet nga rrethanat e rastit, të tilla si intensiteti dhe kohëzgjatja e ndotjes dhe efektet e fizike dhe mendore në shëndetin e individit ose cilësinë e jetesës.

Këto rrethana të elaboruara në jurisprudencën e GJEDNJ-së duhet të jenë pjesë e analizës së fakteve dhe provave të paraqitura nga palët në process gjyqësor dhe duhet të përbëjnë “shtyllat” argumentuese në vendimet gjyqësore mbi çështjet e ndotjes mjedisore. Kjo pasi, në rastin e furrave gëlqerore, ato përbëjnë një fenomen të përsëritur në mënyrë të vazhdueshme, çka ka bërë që intensiteti i ndotjes të jetë i lartë dhe po ashtu edhe kohëzgjatja e kësaj ndotjeje. Ajo çka është vërejtur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit për këtë çështje është se, me përjashtim të rasteve të referuara nga Policia dhe të proceduara penalisht nga Prokuroria, nga banorët ka munguar gjithashtu inisiativa për kërkimin gjyqësor në rrugë civile të të drejtave të tyre të shkelura, për dëmet e mundshme që ata mund të kenë pësuar në shëndetin e tyre si pasojë e kësaj ndotjeje. E para çështje që është iniciuar gjyqësisht, daton në Dhjetor të 2017-ës, ku disa banorë që preken nga aktiviteti i furrave gëlqerore i janë drejtuar Gjykatës Administrative me ndihmën e avokatëve të Klinikës Ligjore Falas të KShH.

Në vendimet gjyqësore të studiuara, përgjithësisht u konstatua se Gjykata ka shpjeguar nga pikëpamja formale elementët e figurës së veprës penale, por jo gjithmonë në mënyrë të thelluar. Në pesë nga këto vendime gjyqësore, Gjykata ka konkluduar se, veprimtaria e ushtruar nga i pandehuri është e jashtëligjshme dhe mungon leja përkatëse për ushtrimin e aktivitetit. Në pjesën më të madhe të rasteve, Gjykata shprehet se janë kryer veprime të kundërligjshme duke mos u ndaluar specifikisht në analizën e kundërligjshmërisë së veprimtarisë së furrave gëlqerore.

Në tre prej vendimeve gjyqësore rezulton se, nuk është bërë analizë e fakteve të çështjes bazuar në provat e administruara gjatë hetimit (të cilat janë bërë pjesë e fashikullit gjyqësor). Gjithashtu, nuk janë analizuar këto prova nën dritën e elementëve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 201, i Kodit Penal. Në këto vendime, menjëherë pas paraqitjes së fakteve, të cilat reflektohen sipas kërkesave për gjykim të Prokurorisë, Gjykata kalon tek dispozitivi i vendimit. Niveli dhe cilësia e arsyetimit të vendimeve gjyqësore është element i rëndësishëm i së drejtës për proces të rregullt si dhe ndikon në rritjen e besimit të publikut në dhënien e drejtësisë dhe ndëshkueshmërinë e rasteve të shkeljes së ligjit që mbron mjedisin dhe shëndetin e tyre.

Nga 15 të pandehur, u konstatua se për 14 prej tyre kanë qenë të padënuar më parë. Një prej tyre, pasi është shpallur fajtor për veprën penale të parashikuar nga Neni 201, i Kodit Penal është proceduar sërish me të njëjtën akuzë penale, por në rastin e fundit, Gjykata kishte vendosur pushimin e procedimit penal për shkak të efekteve të ligjit për amnistinë.

⁵ Vendim i GjEDNJ Tătar kundër Rumanisë 67021/01 datë 27.01.2009;

5.5 Lloji dhe masa e dënimit

Gjykata, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit për të pandehurit ka mbajtur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale për të cilën ata akuzohen, rrezikshmërinë relativisht të ulët të autorëve të cilët rezultojnë të padënuar më parë, si dhe qëndrimin pendues gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit në themel.

Në 13 vendimet për të cilat është zhvilluar proces gjyqësor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë është aplikuar gjykimi i shkurtuar, sipas nenit 403, e vijues të Kodit të Procedurës Penale, mbi bazën e Kërkesës paraprake të të pandehurve. Për rrjedhojë, dënimet (me masa dënimi si 9 muaj burgim, 6 muaj burgim, 300 000 lekë gjobë, 60 000 lekë gjobë, etj) kanë pësuar ulje me 1/3 e tyre në dënimin përfundimtar. **Në 1 nga 14 vendimet e shqyrtuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë është pushuar gjykimi** pasi akuza për të pandehurin sipas nenit 201, të Kodit Penal është pushuar për shkak të përfitimit nga zbatimi i Ligjit nr. 141/2016, “Për dhënie amnistie”.

Në 8 nga 14 vendime, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka aplikuar ndaj të pandehurve të njëjtin lloj dhe masë dënimi me atë të kërkuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Ndërsa, në 1 nga 5 vendimet për të cilat Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur ndryshe nga sa ka kërkuar Prokuroria, gjykata ka rënduar masën e dënimit, por edhe në këtë rast, pozita e të pandehurit është lehtësuar në raport me dënimin e kërkuar nga Prokuroria pasi ndaj tij është vendosur në përfundim, një dënim alternativ, në zbatim të nenit 63, të Kodit Penal, “pezullimi i dënimit me burgim, duke e zëvendësuar me dënimin për të punuar 40 orë në punë me interes publik”.

6. Rekomandime

Duke synuar rritjen e efikasitetit të organeve të drejtësisë penale në parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e mjedisit, jo vetëm sa i takon furrave gëlqerore në fshatrat e Bashkisë Krujë por të çdo aktiviteti tjetër në vendin tonë që ndot mjedisin, duke cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë shëndetin dhe jetën e banorëve, KShH në kuadër të këtij raporti studimor adreson këto Rekomandime:

- a) I rekomandojmë të gjitha institucioneve ligjzbatuese në nivel qendror dhe vendor të zbatojmë me rigorozitet legjisllacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe ti japin fund tolerancës dhe ndërhyrjeve me vonesë.
- b) Është e domosdoshme që Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave dhe Bashkitë, në ushtrim të përgjegjësisë të tyre ligjore për të siguruar kontrollin dhe mbrojtjen e mjedisit të rrisin bashkëpunimin me strukturat e policisë në nivel vendor dhe qendror.
- c) I rekomandojmë strukturave të policisë në nivel vendor dhe qendror të rrisin masat e policimit në komunitet që synojnë parandalimin e krimeve mjedisore, duke zhvilluar një larmishmëri aktivitetesh në marrëdhënie të ngushtë me qytetarët, për t'iu përgjigjur në mënyrë të veçantë nevojave të komuniteteve që janë të riskuara nga ndotja e mjedisit, në zona të ndryshme të vendit.
- d) I rekomandojmë nëpunësve publikë të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, nëpunësve të Bashkisë dhe të gjithë enteve të tjera që nëse gjatë ushtrimit të detyrës për kontrollin dhe mbrojtjen e mjedisit, marrin dijeni për krime në fushën e mjedisit, duhet të bëjnë menjëherë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale. I rekomandohet të gjitha këtyre organeve publike se, kur binden që mosfillimi apo pushimi i çështjes penale nga organet e Prokurorisë nuk është i bazuar, të ushtrojnë brenda afatit ligjor të drejtën e ankimit në gjykatë.
- e) I rekomandohet organit të Prokurorisë që vendimet për mosfillimin e procedimit penal dhe pushimit të çështjes penale të jenë të argumentuara dhe, në mbështetje të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, t'u njoftohet menjëherë enteve përgjegjëse publike të cilat kanë referuar ose denoncuar çështjen në prokurori, ose personave të tjerë denoncues, si dhe të evidentohet në mënyrë të shprehur e drejta e tyre për t'u ankuar në gjykatë.
- f) Organi i procedimit penal dhe në mënyrë të veçantë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë duhet të zhvillojë hetim të plotë, objektiv, të gjithanshëm dhe të shpejtë, ku rekomandohet ndër të tjerash:
 - i) Verifikimi i fakteve nëse aktiviteti i furrave të gëlqeres ushtrohet në përputhje me legjisllacionin në fuqi për sa i takon lejeve (leje mjedisore, leje shfrytëzimi, etj), mbrojtjes së mjedisit, zbatimit të Kodit të Punës, etj.

- ii) Zgjerimi i rrethit të personave të dyshuar që mund t'iu atribuohet vepra penale duke e shtrirë hetimin në mënyrë të veçantë tek organizatorët ose “pronarët” e aktivitetit të furrave gëlqerorë dhe çdo veprimtari tjetër të kundërligjshme që ndot mjedisin. Ndëshkueshmëria e veprave penale në fushën e mjedisit nuk duhet të prekë thjesht hallkat e fundit por duhet të synojë hetimin dhe gjykimin e personave të dyshuar që drejtojnë dhe organizojnë këto veprimtari që përbëjnë vepra penale në fushën e mjedisit.
- iii) Është e domosdoshme që Akti i Ekspertimit tekniko-mjedisor të kryhet, në momentin e konstatimit të shkeljes, pasi në të kundërt, rezultatet e këtij akti nuk do të evidentojnë tejkalim të parametrave të ndotjes, të përcaktuar me akte nënligjore. Nëse ky akt nuk mund të realizohet në momentin e konstatimit të shkeljes, është e rekomandueshme që organi procedues të vendosë kryerjen e eksperimentit konform neneve 176 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale. Në kushtet e eksperimentit, ose siç njihet ndryshe riprodhimin, për aq sa është e mundur, i gjendjes në të cilën fakti ka ndodhur ose çmohet se ka ndodhur, mund të realizohet edhe matja e nivelit të ndotjes me anë të ekspertimit tekniko-mjedisor.
- iv) Rekomandohet që hetimet për veprat penale të lidhura me ndotjen e mjedisit të shtrihen edhe në drejtim të marrjes në pyetje apo të marrjes së dëshmive nga banorë të zonave ku konstatohet ndotja, të cilët mund të kenë dijeni për çështjen dhe që preken apo dëmtohen drejtpërsëdrejti nga ndotja e mjedisit. Në përputhje me nenin 201, paragrafi 2, të Kodit Penal, organi procedues duhet të hetojë nëse ka patur dëmtim në shëndetin dhe jetën e njerëzve si rrjedhojë e ndotjes së shkaktuar nga furrat gëlqerore.
- v) I rekomandohet organit të Prokurorisë të hetojë gjithashtu nëse, organet e ngarkuara me përgjegjësi administrative për inspektimin dhe mbrojtjen e mjedisit, kanë patur ose jo dijeni për krimet mjedisore dhe nëse po, të hetojnë shkaqet e moskallëzimit të krimit. Është tepër e rëndësishme për ndëshkueshmërinë e krimeve mjedisore të hetohet çdo pistë e mundshme e shpërdorimit të pozitave zyrtare apo korrupsionit pasiv nga punonjësit e këtyre organeve administrative, në ushtrim të kompetencave të tyre për inspektimin dhe mbrojtjen e mjedisit.
- g) I rekomandohet Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit, të shikohet mundësia e ndërmarrjes së nismës ligjore për ndryshimin e nenit 201, paragrafi i parë i Kodit Penal, për të parashikuar si element të veprës penale kryerjen e veprës në mënyrë të përsëritur dhe pa lejet përkatëse nga organet kompetente, kur më parë janë marrë masa administrative.